

EUROPA

DREJTOR: ENO TRIMÇEV • KRYEREDAKTOR: JORGJI QIRJAKO • SHEFE E MARREDHENIEVE ME JASHTË: SABINA YMERI

9 maj Dita e Europës

9 MAY
EUROPE DAY



TOGETHER®
SINCE 1957



EUROPEAN UNION



9 maji, Dita e Europës shënon përvjetorin e asaj dite të vitit 1950 kur u konceptua Bashkimi Europian. Ministri i jashtëm i Francës, Robert Shuman, mbajti një fjalim në të cilin u bënte thirrje vendeve europiane të bashkonin prodhimin e tyre të qymyrit dhe të çelikut nën një institucion të vetëm europian, duke shtruar kështu udhën e Bashkimit të sotëm Europian.

Ndoshta shumë pak njerëz në Europë e dinë që më 9 maj 1950 u bë lëvizja e parë drejt krijimit të asaj që sot njihet me emrin Bashkimi Europian. Atë ditë në Paris, kundrejt sfondit kërcënues të Luftës së Tretë Botërore që mund të gllabëronte gjithë Europën, Ministri i Jashtëm i Francës Robert Shuman lexoi para shtypit ndërkombëtar një deklaratë që i bënte thirrje Francës, Gjermanisë dhe vendeve të tjera europiane të bashkonin prodhimin e qymyrit dhe çelikut si 'themeli i parë prej betoni i një federate europiane.' Ajo që propozoi ai ishte krijimi i një institucioni europian mbikombëtar, i ngarkuar me administrimin e industrisë së qymyrit dhe çelikut, pikërisht sektori që në atë kohë ishte baza e gjithë fuqisë ushtarake. Vendet, të cilave ai u bëri thirrje, gati e kishin shkatërruar njeri tjetrin në një konflikt të tmerrshëm që kishte lënë pas një ndjenjë rrëtimi moral dhe material. Ndaj gjithçka nisi atë ditë. Për këtë arsye gjatë Samitit të Milanos, në vitin 1985, udhëheqësit e BE-së vendosën ta festojnë 9 majin si 'Dita e Europës'. Çdo vend që zgjedh në mënyrë demokratike të hyjë në Bashkimin Europian nënshkruan vlerat e tij fundamentale të paqes dhe solidaritetit. Këto vlera gjejnë shprehje në sajë të zhvillimit ekonomik dhe social që përfshin dimensione rajonale dhe mjedisore që janë garanci për standardet e duhura të jetesës për gjithë qytetarët.

Ndërsa Europa ka ekzistuar si e tillë prej shekujsh, elementët që e bashkonin atë, në mungesë të rregullave dhe institucioneve, në të kaluarën ishin të pamjaftueshme për të parandaluar tragjedi nga më të tmerrshmet.

FAQE 3

Në këtë numër:

9 maj, Dita e Europës

FAQE 3

Statusi i Kosovës

FAQE 4

"Deficit European"

FAQE 8

Demokracia e Kosovës dhe Serbisë

FAQE 10

Politika rajonale e BE-së

FAQE 14

EU INTERESANTE

FAQE 15